



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT



Tabela e Përmbajtjes

SHKURTIMET	3
Hyrje	4
1. Profili Institucional	5
1.1 Vizioni.....	5
1.2 Baza ligjore.....	6
1.3 Struktura	6
2 Veprimtaria dhe Rezultatet Kryesore	7
2.1 Objektivat e QKB	7
2.2 Reformat legjislative dhe strukturore të ndërmarra, përfshirë ndryshimet në kuadrin rregullator dhe organizativ	8
2.3 Aktivitete të tjera gjatë periudhës 1 janar – 31 dhjetor 2025.....	8
3 Treguesit Statistikorë dhe Analiza.....	10
4 Bashkëpunimi ndërinstitutional	19
5 Prioritetet për vitin pasardhës	20
5.1 Sfidat	21
6 Aneks	23

SHKURTIMET

QKB	Qendra Kombëtare e Biznesit
AKSHI	Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit
ILDKPKI	Inspektoriati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave
KLGI	Këshilli i Lartë Gjyqësor
KPK	Komisioni i Pavarur i Kualifikimit
HRMIS	Sistemi i Menaxhimit të Burimeve Njerëzore
RT	Regjistri Tregtar
RLLA	Regjistri i Licencave, Lejeve dhe Autorizimeve
RPP	Regjistri i Pronarëve Përfitues
MONEYVAL	Komiteti i Ekspertëve për Vlerësimin e Luftës Kundër Pastrimit të Parave

Hyrje

Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB) është institucion i administratës shtetërore me personalitet juridik, në varësi të Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit. QKB luan një rol kyç në administrimin e informacionit dhe procedurave të lidhura me regjistrimin dhe funksionimin e bizneseve në Republikën e Shqipërisë.

Funksionet kryesore të QKB-së përfshijnë:

➤ **Regjistri Tregtar**

- Mbajtja dhe administrimi i regjistrit tregtar në përputhje me ligjin Nr. 9723, datë 03/05/2007, “Për regjistrimin e biznesit”, i ndryshuar.
- Kryerja e regjistrimeve, ndryshimeve dhe përditësimeve të të dhënave të subjekteve tregtare.
- Publikimi i të dhënave të regjistruara dhe sigurimi i aksesit të lirë për publikun.

➤ **Regjistri i Licencave, Autorizimeve dhe Lejeve**

- Trajtimi i procedurave për dhënie, ndryshimin dhe revokimin e licencave, autorizimeve dhe lejeve, sipas ligjit përkatës.
- Administrimi i Regjistrit të Licencave, Autorizimeve dhe Lejeve.
- Sigurimi i qasjes së lirë të publikut në të dhënat e këtij regjistri.

➤ **Regjistri i Pronarëve Përfitues**

- Administrimi i regjistrit të pronarëve përfitues, duke përfshirë regjistrimin, përpunimin dhe ruajtjen e të dhënave të deklaruara nga subjektet raportuese.

QKB kontribuon në rritjen e transparencës, përmirësimin e administrimit të biznesit dhe sigurimin e aksesit të lirë për publikun në informacionet e rëndësishme tregtare dhe ligjore, duke mbështetur zhvillimin e një ambienti të besueshëm për sipërmarrjen dhe investimet.

1. Profili Institucional

Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB) është institucion i administratës shtetërore me personalitet juridik, në varësi të Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit. Drejtoritë e QKB-së kanë funksionuar si pika kyçe kontakti institucionale, duke garantuar komunikim të qartë, të besueshëm dhe në kohë reale me të gjithë subjektet e interesuara.

Qendra Kombëtare e Biznesit ka siguruar shqyrtimin e aplikimeve për të tre regjistrat administrativë në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, standardet e shërbimit publik, si dhe kërkesat për transparencë dhe mbrojtje të të dhënave personale. Pjesëmarrja aktive e stafit në grupe pune për përmbushjen e detyrave brenda afateve të caktuara ka mundësuar përmirësimin e procedurave dhe rritjen e efikasitetit institucional.

Ky rol ka kontribuar drejtpërdrejt në rritjen e besimit të publikut ndaj shërbimeve elektronike të QKB-së dhe ka përmirësuar perceptimin mbi cilësinë e shërbimit publik, duke forcuar transparencën, llogaridhënien dhe aksesin në informacionet publike.

1.1 Vizioni

Vizioni i Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) lidhet ngushtë me modernizimin e administratës publike dhe krijimin e një mjedisi sa më miqësor për biznesin. Një QKB moderne, transparente dhe e orientuar drejt shërbimit është një faktor thelbësor për klimën e biznesit. Fokusi i saj kryesor është të ofrojë shërbime që përmirësojnë efikasitetin dhe transparencën e administratës publike, duke ofruar një platformë të sigurt dhe të besueshme për regjistrimin e bizneseve dhe ofrimin e shërbimeve për çdo individ ose kompani që dëshiron të angazhohet në aktivitetet ekonomike të vendit. Bashkëpunimi më i ngushtë me institucione të tjera publike do të mundësojë shërbime të integruara dhe një përvojë më efikase për biznesin.

Qendra Kombëtare e Biznesit po krijon një mjedis modern dhe gjithëpërfshirës për biznesin, ku shërbimet publike janë të thjeshta, të shpejta dhe të orientuara drejt nevojave të sipërmarrësve. Këto shërbime mundësojnë kryerjen e procedurave në afate të shkurtra dhe me një proces të thjeshtuar, për regjistrimin dhe licencimin e bizneseve, si dhe regjistrimin e pronarëve përfitues, përmes portalit qeveritar e-albania. QKB mund të luajë një rol më aktiv në informimin dhe orientimin e bizneseve të reja, startup-eve dhe sipërmarrjeve inovative.

Përmes digjitalizimit të shërbimeve, QKB synon:

- të jetë institucioni lider dhe i besueshëm në mbështetjen e zhvillimit të biznesit në Shqipëri, duke ofruar shërbime efikase, transparente dhe inovative, që nxisin sipërmarrjen;
- të jetë ura që lidh idetë sipërmarrëse duke fuqizuar bizneset dhe duke kontribuar në zhvillimin e qëndrueshëm të vendit;
- të zgjerojë shërbimet elektronike, automatizimin e proceseve dhe përdorimin e platformave inteligjente që do të reduktojnë burokracinë, kostot dhe kohën për bizneset;


- të rishikojë dhe harmonizojë procedurat administrative të cilat do ta bëjnë ndërveprimin e biznesit me shtetin më të lehtë dhe më transparent;
- përmirësimin e aksesit në informacion të saktë dhe të përditësuar, duke rritur sigurinë juridike dhe besimin e investitorëve vendas dhe të huaj.

1.2 Baza ligjore

Qendra Kombëtare e Biznesit ushtron funksionet e saj në bazë të kuadrit ligjor në fuqi, duke përfshirë:

- Ligjin Nr. 131/2015, “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit”;
- Ligjin Nr. 9723, datë 03/05/2007, “Për regjistrimin e biznesit”, i ndryshuar;
- Ligjin Nr. 10081, datë 23/02/2009, “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligjin Nr. 112/2020, “Për Regjistrin e Pronarit Përfitues”, i ndryshuar, si dhe aktet nënligjore të
- nxjerra në zbatim të këtyre ligjeve.

1.3 Struktura



2 Veprimtaria dhe Rezultatet Kryesore

2.1 Objektivat për vitin 2026

- Përmirësimi i sistemeve, faqes së web dhe modulit të statistikave duke përfshirë të tre regjistrat e Qendrës Kombëtare të Biznesit.
- Vijimi i punës për miratimin e ndryshimeve ligjore të propozuara në vitin 2024, në kuadër të procesit të Riinxhinierimit dhe Derregullimit (Ligji Nr. 10081/2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”; Ligji Nr. 9723, 03.05.2023 “Për Regjistrimin e Biznesit”, i ndryshuar, Ligji 131/2015 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit”, i ndryshuar).
- Përfaqësimi dhe dhënia e kontributit për hartimin e strategjisë kombëtare për parandalimin e pastrimin të parave dhe financimit të terrorizmit 2024-2030.
- Menaxhimi i veprimtarisë financiare dhe administrimi i burimeve njerëzore të QKB-së në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator, si dhe përmirësimi i kapaciteteve të tyre.
- Raportimi periodik në Ministrinë e Ekonomisë dhe Inovacionit dhe institucione të tjera që kemi marrëveshje.
- Përmirësimi i cilësisë së shërbimit ndaj subjekteve përmes fushatave sensibilizuese, informuese dhe ndërmjetësuese, me fokus në promovimin e shërbimeve të QKB-së dhe rritjen e përqindjes së popullimit të Regjistratit të Pronarëve Përfitues.
- Vazhdimësia e përmirësimit të shërbimeve me qëllim lehtësimin e procedurave për individët/subjektet si konsolidimi i Pasqyrave Financiare dhe dorëzimi i tyre në një institucion të vetëm (në bashkëpunim me DPT), ndërveprimi në kohë reale për detyrimet në kuadër të shërbimit të cregjistrimit, marrja e infomacioneve nëpërmjet ndërveprimit si për Përmbaruesit, ILDKPI, me qëllim shmangien e volumit të shkresave.
- Raportimi për kapitujt në të cilët Qendra Kombëtare e Biznesit është anëtare dhe ka obligimin për të ofruar një kontribut të vazhdueshëm kur kërkohet nga Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit, Ministria e Drejtësisë dhe institucione të tjera përkatëse.
- Përmirësimi i ofrimit të asistencës së vazhdueshme për subjektet përsa i përket procesit të regjistrimit të biznesit, licencimit/lejimit të biznesit dhe regjistrimit të pronarëve përfitues

2.2 Reformat legislative dhe strukture të ndërmarrë, përfshirë ndryshimet në kuadrin rregullator dhe organizativ

Në kuadër të Kapitullit 6 "Legjislacioni për shoqëritë tregtare", nga ana e Qendrës Kombëtare të Biznesit, për sa i takon fushës së saj të përgjegjësisë, janë ndërmarrë hapat për ndryshimet ligjore konkretisht për:

- Ligjin Nr. 131/2015 "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit";
- Ligjin Nr. 9723, datë 03.05.2007 "Për regjistrimin e biznesit";
- VKM 391, datë 3.5.2017, "Për përcaktimin e procedurave të regjistrimit dhe të publikimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit".

Gjithashtu, në zbatim të Urdhrit të Kryeministrit Nr. 222, datë 26.11.2025, "Për ngritjen e grupit ndërinstitucional të punës për përputhshmërinë e kuadrit ligjor në fushën e parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit me acquis të Bashkimit Evropian", nga ana e QKB-së janë ndërmarrë hapat për ndryshimin ligjorë të:

- Ligjit Nr.112/2020 "Për regjistrin e pronarëve përfitues"

Në kuadër të kapitullit 3 "E drejta e vendosjes dhe liria për të ofruar shërbime" dhe kapitullit 18 "Statistika" anëtarët e saj kanë marrë pjesë në takimet e zhvilluara.

2.3 Aktivitete të tjera gjatë periudhës 1 janar – 31 dhjetor 2025

- Në datën 3 dhe 4 prill 2025, Qendra Kombëtare e Biznesit, ishte pjesëmarrëse në European Business Registry Association (EBRA) [Shoqata e Regjistrave Tregtarë Europianë], të organizuar në Lisbonë, Portugali. Gjatë konferencës, QKB ndau përvojën shqiptare në drejtim të dixhitalizimit të proceseve dhe rritjes së transparencës për qytetarët dhe bizneset. Përfaqësuesit e institucionit prezantuan zhvillimet më të fundit që synojnë modernizimin e shërbimeve, lehtësimin e procedurave dhe ofrimin e një qasjeje më efikase për përdoruesit. Temat kryesore të trajtuara gjatë konferencës përfshinë:
 - Modernizimin e regjistrave të biznesit në Evropë,
 - Sigurinë dhe mbrojtjen e të dhënave,
 - Interoperabilitetin ndërmjet regjistrave të vendeve anëtare,
 - Rolin e regjistrave në luftën kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.
- Për periudhën Maj-Qershor, Qendra Kombëtare e Biznesit ka marrë pjesë në gjitha takimet GTNP, (Grupit Teknik Ndërinstitucional të Punës), të zhvilluara në Pallatin e Kongreseve. Gjithashtu, në datën 5.06.2025, Qendra Kombëtare e Biznesit mori pjesë në takimin online të zhvilluar me ekspertin znj. Ramandeep Chinna, mbi draft raportin mbi IO5, të përgatitur nga ekspertja. Gjithashtu, në vijim të raportimeve dhe takimeve, Qendra Kombëtare e Biznesit ka vijuar, për periudhën korrik-dhjetor, të marrë pjesë në gjitha takimet GTNP, (Grupit Teknik Ndërinstitucional të Punës), të zhvilluara në Pallatin e Kongreseve dhe brenda fushës së saj të përgjegjësisë, ka plotësuar pyetësoni i teknikalishtet dhe efektivitetit.

- Në datën 04 dhe 05 Qershor 2025, Qendra Kombëtare e Biznesit, ishte pjesëmarrëse në European Business Registry Association (EBRA) [Shoqata e Regjistrave Tregtarë Europeanë], të organizuar në Bruksel, ku shtetet anëtare në formën e Grupit të Punës, nëpërmjet diskutimeve kanë shkëmbyer eksperiencat e tyre dhe praktikat më të mira në fushën e regjistrimit të biznesit dhe të pronarëve përfitues. Në fokus të takimit ishte:
 - Legjislacioni evropian;
 - Sfidat për deklarimin e të dhënave të pronarëve përfitues;
 - Të dhënat e deklaruar;
 - Perjashtimi nga deklarimi i Pronarit Përfitues
- Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB) mori pjesë në Konferencën e dytë Vjetore të Shoqatës Evropiane të Regjistrave të Biznesit (European Business Registry Association – EBRA), e cila u zhvillua në qershor 2025 në Milano, Itali.
- Më datë 16-17 Korrik, Qendra Kombëtare e Biznesit, ishte pjesëmarrëse në European Business Registry Association (EBRA) [Shoqata e Regjistrave Tregtarë Europeanë], të organizuar në Gdansk (Poloni), ku shtetet anëtare në formën e Grupit të Punës, nëpërmjet diskutimeve kanë shkëmbyer eksperiencat e tyre dhe praktikat më të mira në fushën e dixhitalizimit, të të dhënave të hapura dhe sigurisë kibernetike. Në fokus të takimit ishte:
 - Rrjeti i sigurisë kibernetike;
 - Dixhitalizimi dhe të dhënat e hapura;
 - Portofoli i Biznesit i BE-së dhe mjete të tilla si nënshkrimet dixhitale, vulat, dhe arkivimi elektronik, si mjete që mund të lehtësojnë barrën administrative dhe të rrisin sigurinë në fusha kyçe si dokumentacioni financiar, menaxhimi i kontratave dhe transaksionet ndërkufitare.
- Në datën 27-28 Tetor, Qendra Kombëtare e Biznesit, ishte pjesëmarrëse në European Business Registry Association (EBRA) [Shoqata e Regjistrave Tregtarë Europeanë], të organizuar në Bruksel, ku shtetet anëtare në formën e Grupit të Punës, nëpërmjet diskutimeve kanë shkëmbyer eksperiencat e tyre dhe praktikat më të mira në fushën e regjistrimit të pronarëve përfitues. Në fokus të takimit ishte:
 - Legjislacioni evropian mbi regjistrimin e të dhënave të pronarëve përfitues;
 - Praktika e regjistrimit të të dhënave të pronarëve përfitues nga shteti francez.
- Më datë 09-10 Dhjetor, Qendra Kombëtare e Biznesit, ishte pjesëmarrëse në European Business Registry Association (EBRA) [Shoqata e Regjistrave Tregtarë Europeanë], të organizuar në Cologne (Gjermani), ku shtetet anëtare në formën e Grupit të Punës, nëpërmjet diskutimeve kanë shkëmbyer eksperiencat e tyre dhe praktikat më të mira në fushën e inovacionit dixhital, regjistrimit të biznesit dhe të pronarëve përfitues. Në fokus të takimit ishte:
 - Inovacioni dixhital dhe operacionet e Regjistrave;
 - Praktikë më të mira në lidhje me regjistrimin e pronarëve përfitues.
- Drejtoria e Regjistrimit të Pronarëve Përfitues ka marrë pjesë në mënyrë aktive në takime me

subjekte tregtare, të cilat kanë pasur si qëllim sqarimin në mënyrë ezauruese të subjektit dhe asistencën për zgjidhjen e problematikave të hasura gjatë procedurave të regjistrimit dhe përditësimit të të dhënave të pronarëve përfitues.

- Drejtoria e Regjistrimit të Pronarëve Përfitues ka marrë pjesë në një sërë grupe pune, të cilat kanë pasur si qëllim përmirësimin e problematikave që lindin nga proceset e përditshme të veprimtarisë së QKB-së.
 - Urdhër Nr. 54, date 07.05.2025 “Për ngritjen e grupit të punës për ndjekjen me qëllim plotësimin e pyetësoreve në kuadër të Raundit të 6-të, të vlerësimit nga Komiteti Moneyval”.
- Grupi i punës në kuadër të raportimit të Moneyval ka dhënë kontribut për plotësimin e formularëve të teknikalitetit dhe efektivitetit, duke respektuar afatin për plotësimin e tyre.
 - Urdhër Nr. 23, date 20.02.2025 “Për ngritjen e grupit të punës për strukturimin e arsyeve të refuzimit/pezullimit për të tre regjistrat”
- Grupi i punës ka rishikuar strukturimin e arsyeve të refuzimit/pezullimit, me qëllim që ato të jenë të qarta dhe të arsyetuara
 - Urdhër Nr. 21, date 13.02.2025 “Për ngritjen e grupit të punës për përditësimin dhe rishikimin e faqes zyrtare të website-it të Qendrës Kombëtare të Biznesit

Ky grup pune ka plotësuar dhe azhornuar faqen e website-it zyrtar qkb.gov.al duke dhënë informacion të saktë dhe të përditësuar sipas rubrikave, fushave, dokumentacionit dhe të dhënave të nevojshme.

3 Treguesit Statistikorë dhe Analiza

Në të tre regjistrat e administruar nga QKB janë shqyrtuar **137 087** aplikime, ku të ndara sipas regjistrave janë:

- **114 504** aplikime në Regjistrin Tregtar:
- **13 103** aplikime në Regjistrin e Lejeve/Licencave, dhe Autorizimeve
- **9 480** aplikime në Regjistrin e Pronarëve Përfitues

3.1 Drejtoria e Regjistrimit të Biznesit dhe Lejeve/Licencave/Autorizimeve|


- Sektori i Regjistrimit të Biznesit

Gjatë vitit 2025 janë kryer **114 504** aplikime në Regjistrin Tregtar, nga të cilat:

- **93 516** aplikime të miratuara pa përfshirë pasqyrat financiare
- **20 350** aplikime të refuzuara pa përfshirë pasqyrat financiare
- **32 295** aplikime për dorëzimin e pasqyrave financiare të miratuara
- **8 739** aplikime për dorëzimin e pasqyrave financiare të refuzuara

Të ndara sipas llojit aplikime të tjera dhe aplikime për dorëzimin e pasqyrave financiare janë:

- **113 866** janë aplikime për regjistrime fillestare, ndryshime, pezullime, aktivizime, çregjistrime;
- **41 034** janë aplikime për dorëzim të pasqyrave financiare.



Sipas të dhënave të paraqitura në grafik, gjatë vitit 2025 është regjistruar një numër më i ulët i aplikimeve të tjera në Regjistrin Tregtar krahasuar me vitin 2024. Kjo ulje e numrit të aplikimeve ka ardhur si pasojë e përmirësimit të sistemit elektronik duke sjellë saktësime në regjistrime dhe uljen e numrit të aplikimeve të shumëfishta për të njëjtin shërbim.

Ndërkohë, në vitin 2025 evidentohet një rritje e numrit të aplikimeve për depozitimin e pasqyrave financiare në raport me vitin paraprak. Kjo rritje reflekton funksionalizimin e plotë të këtij shërbimi, i cili ka lehtësuar procedurat dhe ka rritur nivelin e përdorimit nga ana e subjekteve.

Gjatë këtij viti nga Drejtoria e RT statistikatat për shkresat janë:

- **9 194** Shkresa drejtuar organeve tatimore/prokurorisë/agjencisë/gjykatës/përmbaues etj.
- **9 980** Shkresa ardhur nga organet tatimore/prokuroria/agjencia/gjykata/përmbaues etj.

➤ Sektori i Regjistrin të Leje/Licencave dhe Autorizimeve

Gjatë vitit 2025 janë kryer **13 103** aplikime të shqyrtuara në Regjistrin Kombëtar të Lejeve/Licencave, dhe Autorizimeve


- **4 016** aplikime të miratuara
- **9 087** aplikime të refuzuara

Të ndara sipas llojit leje apo licencë janë:

- **11 558** janë aplikime për licenca
- **1 545** janë aplikime për leje.

Duke krahasuar të dhënat e numrit të aplikimeve në Regjistrin e Leje/Licencave dhe Autorizime me vitin 2024 në të cilin janë regjistruar 12 726 aplikime, në vitin 2025 vihet re një rritje e aplikimeve të miratuara dhe ulje e aplikimeve të refuzuara.

- **1 145** shkresa të ardhura nga institucionet e tjera.




3.2 Drejtoria e Regjistrimit të Pronarëve Përfitues

Gjatë vitit 2025 në Regjistrin e Pronarëve Përfitues janë kryer **9 480** aplikime

- **9 114** aplikime nga Subjektet tregtare;
- **366** aplikime nga Organizatat jo fitimprurëse.

Gjatë vitit 2024 janë regjistruar 8 821 aplikime në Regjistrin e Pronarëve Përfitues, nga të cilat 8475 aplikime nga Subjekte tregtare dhe 346 aplikime nga Organizatat jo fitimprurëse.

Krahasimi i shifrave 2024 – 2025 vërehen në grafikun e mëposhtëm;



Gjatë vitit 2025 në Regjistrin e Pronarëve Përfitues janë shqyrtuar 9 480 aplikime nga të cilat

- Miratuar aplikimi 5 356
- Miratuar aplikimi (Përditësim) 2 742
- Refuzuar Aplikimi 986
- Refuzuar Aplikimi (Përditësim) 388
- Refuzo nga RPP 8
- Gjatë vitit 2025, për subjektet tregtare dhe OJF, që nuk kanë bërë regjistrimin fillestar ose ndryshimet në të dhënat e pronarëve përfitues në përputhje me afatet ligjore, janë vendosur penalitete sipas parashikimeve ligjore.
- Për vitin 2025, janë dërguar 23 njoftime drejt subjekteve raportuese, bazuar në informacionin e përcjellë nga bankat e nivelit të dytë, me lëndë njoftim mbi mospërputhjen e të dhënave në Regjistrin e Pronarëve Përfitues.

3.3 Drejtoria e Asistencës Online dhe Trajtimit të të Dhënave:

- Nga 1 Janar 2025 deri në 31 Dhjetor 2025 janë trajtuar 19 488 emaile të mbërritura në Qendrën Kombëtare të Biznesit nëpërmjet kanaleve të komunikimit zyrtar:
- Janë asistuar nëpërmjet linjës telefonike 12 374 subjekte gjatë vitit 2025, ku janë sqaruar mbi pyetjet mbi mënyrën e aplikimit në portalin e-albania, procedurën që ndiqet në aplikim, dokumentacionin e nevojshëm, janë sqaruar mbi ecurinë e aplikimeve apo problematikat e hasura gjatë aplikimit.
- Janë dhënë 3 971 përgjigje përmes shërbimit “Chat”

- Janë trajtuar 455 kërkesa përmes sistemit “Ticket”
- Janë trajtuar 12 316 shkresa (të dërguara dhe të ardhura në QKB)
- Janë 2, 727 aplikime të hapura kryesisht me kërkesë të palëve të treta

Janë trajtuar brenda afateve ligjore të gjithë shkresat e paraqitura nga subjektet për pajisjen me kopje të njejtë me origjinalin të dosjes elektronike:

- Nga 1 Janari 2025 deri më 31 Dhjetor 2025 janë trajtuar 321 kërkesa.

Janë trajtuar brenda afateve e gjithë korrespondenca me drejtoritë rajonale tatimore në lidhje me dërgimin e certifikatave të çregjistrimit të subjekteve:


- Nga 1 Janari 2025 deri në 31 Dhjetor 2025 janë dërguar 3, 732 certifikata çregjistrimi.

Ndërkohë, në kuadër të bashkëpunimit ndërinstitucional, QKB-ja trajton kërkesa për informacion për të dhënat e regjistruara dhe të publikuara në të tre regjistrat që administrohen nga QKB-ja, që vijnë nga Prokuroria, Gjykatat, ILDKPKI, KLGJ, KPK, Përmbarues, etj.,

- Nga 1 Janari 2025 deri në 31 Dhjetor 2025 janë dërguar 1 670 përgjigje shkresore.

Të gjitha kërkesat e administruara nga QKB-ja gjatë vitit 2025, janë trajtuar brenda afateve ligjore dhe në përputhje me parashikimet ligjore në fuqi.

- Nga 1 Janari 2025 deri në 31 Dhjetor 2025 janë trajtuar 47 kërkesa në bazë të ligjit për të drejtën e informimit.



Këta tregues pasqyrojnë jo vetëm volumin e lartë të punës, por edhe rritjen graduale të përdorimit të kanaleve digjitale, si dhe nivelin e konsoliduar të bashkëpunimit institucional dhe administrimit korrekt të të dhënave ndërinstitucionale gjatë vitit 2025.

3.4 Drejtoria e Kërkimit dhe Udhëheqjes Metodologjike

Nga 1 Janar 2025 deri në 31 Dhjetor 2025 janë trajtuar:

- 850 shkresa
- 525 ankesa
- 61 gjyqe të reja
- 10 gjyqe të përfunduara nga të cilët 4 gjyqe janë të viteve të shkuara.
- 84 gjyqe janë në proces

3.5 Drejtoria e Regjistrave dhe Analizës

Gjatë vitit 2025, krahas raportimeve të ndryshme dhe analizës së të dhënave, ka kryer si më poshtë:

- 2 470 shkresa të publikuara në faqen web (vendime gjykate, përmbarduesish, njoftime doganore, ftesa kreditorësh etj.)
- 60 shkresa (përgjigje të kthyer për njoftime që nuk mund të publikohen)
- 99 raporte të kërkuara nga ministritë, institucione të tjera të linjës, organizmave publikë dhe privatë, në varësi të projekteve apo zhvillimeve ku kërkohet bashkëpunim ndër-institucional.
- 74 përgjigje ndaj kërkesave të institucioneve apo subjekteve të ndryshme për informacione shtesë ose shërbime dytësore, në përputhje me kuadrin ligjor dhe kompetencat institucionale të QKB-së.
- Dërgimi periodik i informacionit mbi regjistrimet, ndryshimet dhe çregjistrimet e miratuara drejt DPTTV dhe njësive vendore, si dhe komunikimi me drejtoritë rajonale tatimore për subjektet që tërhiqen nga aplikimi për çregjistrim.
- Përpunimi i të dhënave të dërguara nga njësia TIK dhe raportimi mujor drejt MEI, mbi subjektet e regjistruara dhe të çregjistruara sipas qarkut, formës ligjore, pronësisë, kategorisë ekonomike ose subjektet e pezulluara dhe të aktivizuara.
- Përgatitja e raporteve mujore analitike mbi regjistrimet, çregjistrimet, pezullimet dhe riaktivizimet e subjekteve, të krahasuara me periudhat e viteve të mëparshme, duke u bazuar në kategoritë e pronësisë dhe format ligjore të tyre.
- Përgatitja e raportit javor, mujor dhe vjetor analitik mbi punën e kryer bazuar në të dhënat e secilës drejtori të QKB-së.
- Hartimi dhe dorëzimi i raporteve ditore mbi gjobat e vendosura në Regjistrin Tregtar dhe në Regjistrin e Pronareve Përfitues, duke garantuar saktësi dhe përditësim të vazhdueshëm të bazave të të dhënave.
- Raportimi i përditshëm mbi detyrimet e subjekteve ndaj bashkive, lidhur me aplikimet e kryera për pezullim aktiviteti dhe verifikimin e statusit të tyre në sistemet respektive

- Hartimi i raportit mujor mbi aplikimet e reja dhe ndryshimet e kryera në Regjistrin e Lejeve, Licencave dhe Autorizimeve, të ndara sipas kategorive përkatëse të lejeve/licencave.
- Përpunimi i të dhënave të dërguara nga njësia TIK dhe raportimi në institucionet me të cilat QKB ka marrëveshje bashkëpunimi, përfshirë Bankën e Shqipërisë, INSTAT, Raiffeisen Bank, ISHPSHSH, APP dhe kompani private (LRC), sipas afateve dhe kërkesave zyrtare.

3.6 Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse

➤ *Në Sektorin e Shërbimeve të Brendshme janë kryer si më poshtë :*

- Administrimi i dosjeve të personelit sipas legjislacionit të shërbimit civil. Plotësimi i librezave të punës, hedhja e të dhënave në Regjistrin e personelit (HRMIS) dhe Regjistrin Themeltar të personelit në kohë, në zbatim të legjislacionit në fuqi.
- Planifikimi, menaxhimi dhe zbatimi i planit të rekrutimit, kryerja e procedurave të shpalljeve të pozicioneve vakante, analiza e krijimit të një pozicioni pune të ri etj. Gjithsej, për vitin 2025, janë shpallur 9 pozicione vakante në shërbimin civil dhe është dërguar kërkesa në Ministrinë e Financave për miratimin e 12 punonjësve me kontratë të përkohshme për nevoja të institucionit.
- Grumbullimi dhe përpunimi informacionit për përditësimin e dosjeve të personelit (diploma, leje vjetore, çertifikata, vendime etj).
- Ndjekja e zbatimit të Etikës nga punonjësit.
- Ndjekja e procesit të vlerësimit periodik të punonjësve, sipas formatit me objektiva të përcaktuara në formularin tip në përputhje me legjislacionin në fuqi. Janë vlerësuar për periudhën 6 mujore, Janar – Qershor 2025, 58 nëpunës civil, është kryer vlerësimi për periudhën e vlerësimit vjetor Korrik – Dhjetor të 69 nëpunësve civil.
- Shqyrtimi menjëherë dhe duke respektuar afatet ligjore i kërkesave të punonjësve apo i kërkesave të tjera sipas delegimit.
- Ndjekja dhe azhurnimi i çështjeve për deklarinimin e pasurisë nga personat përgjegjës sipas legjislacionit përkatës.
- Ndjekja dhe organizimi i programeve të trajnimit për nëpunësit e QKB si dhe parashikimi trajnimeve për vitin 2026, duke bashkëpunuar me drejtoritë e QKB-se.
- Hedhja e të dhënave të protokollit në regjistrat përkatës dhe në një databazë të posaçme elektronike. Numri total i shkresave hyrëse dhe dalëse në muaj është mesatarisht 8000.
- Administrimi i praktikave të protokolluara sipas problematikës dhe periudhës së trajtimit.
- Qarkullimi sipas destinacionit, i korrespondencës shkresore, marrja, dërgimi dhe përpunimi i shkresave zyrtare të QKB të brendshme apo me të tretë, jashtë institucionit.

- Inventarizim fizik i dokumentacionit në dosjet e subjekteve tregtare. Çdo ditë përpunohen mesatarisht 150 fletë në ditë.
- Sistemimi në rafte sipas një rendi të caktuar dhe aksesim/evidentim i dosjeve, sipas procesi i ndarjes sipas qyteteve, sipas vendimeve të gjykatës, procesi i ndarjes sipas NIPT, krijimi i njësi ruajtjeje.
- Organizimi i brendshëm i dosjes dhe përshkrim në fillim të dosjes, i të gjithë elementeve që përmban dosja.
- Bazuar në kërkesat e sektorëve, (përfshirë gjykatat dhe prokurorinë etj) vendosja në dispozicion të tyre, e dosjeve apo praktikave pranë arkivës fizike të institucionit.
- Sigurimi i kushteve dhe bazës materiale për funksionimin e sistemit të ndricimit, ngrohjes, ftohjes, pastrimit, paisjeve hidrosanitare etj.
- Realizuar gjithsej 24 procedura prokurimi me blerje të vogla
- Realizuar gjithsej 9 procedura blerje të vogla deri në 100 000 lekë, për plotësimin e nevojave institucionale, në përputhje me regjistrin e parashikimeve për vitin 2025
- Kërkesa për pajisje kompjuterike, e dërguar pranë AKSHI-t në fillim të vitit, ndodhet në pritje të zhvillimit të procedurës dhe furnizimit, pa një përgjigje zyrtare nga AKSHI deri në këtë moment.
- Mirëmbajtja dhe mirëfunksionimi i gjeneratorit të godinës.
- Ndjekja e procesit të mirëmbajtjes dhe rregullimeve teknike në infrastrukturën logjistike të godinës.
- Vende vakante për vitin 2026 janë 4, nga këto janë 2 pozicione ekzekutive, 2 pozicione të mesëm drejtues, ky informacion është kërkuar dhe i është dërguar MEI.
- Janë zhvilluar 5 procedura disiplinore, të cilat janë ndërprerë, duke mos u marrë asnjë masë disiplinore ndaj nëpunësve të QKB-së.
- Janë lidhur dy kontrata shërbimi me dy këshilltarë të jashtëm për Drejtorin e Përgjithshëm të QKB-së.

➤ Në *Sektorin e Financës* është kryer veprimtaria si më poshtë:

- Fondet buxhetore të ndryshuara për vitin 2025 për QKB-në në total janë 137 764 280 lekë prej të cilave 135 189 520 lekë janë shpenzimet korrente dhe 2 574 760 lekë për shpenzime kapitale. Këto fonde, sipas zërave të strukturës buxhetore, paraqiten sipas tabelave të mëposhtme, ku jepen edhe realizimet përkatëse për secilin prej tyre për vitin 2025.

• “Shpenzimet korrente” 2025

Llogaria	E M E R T I M I	Buxheti i vitit 2025			
		PLAN	FAKTI	Diferenca	%
6009999	SHPENZIME PAGE	94 497 375	94 386 306	111 069	99.8
6019999	SHPENZIME SIGURIME SHOQERORE SHENDETSORE	15 629 640	15 629 489	151	99.9
6029999	SHPENZIME KORRENTE	24 627 000	18 862 098	5 764 902	76.6
6050000	TRANSFERTA ME JAShte	303 000	303,000	0	100
6060000	TRANSFERTA ME INDIVIDE, NDIHMA EKONOMIKE	132 433	132 433	0	100
	SHPENZIME KORRENTE DHE KAPITALE	135 189 448	129 313 326	5 876 122	95

Në zërin Shpenzime Operative, ndërkohë që parashikimi i buxhetit 12 mujor ishte 24 627 000 lekë, realizimi është në vlerën 18 862 098 lekë ose në masën 76%.

Realizimi i Fondit të pagave dhe Sigurimeve Shoqërore në periudhën 12-mujore, për artikull 600 është realizuar në vlerën 94 386 306 ose në masën 99.8 %, ndërsa për artikull 601 është realizuar në vlerën 15 629 489 lekë ose në masen 91% të buxhetit.

• “Investime”

Llogaria	E M E R T I M I	Buxheti investime i vitit 2025			
		PLAN I ndryshuar	FAKT	Diferenca	%
231	Paisje kompjuterike	3 680 000	2 040 240	1 639 760	55%
230	Projekt rikonstruksioni	120 000	99 000	21 000	83%
II	Shpenzime Kapitale	3 800 000	2 139 240	1 660 760	56%

Referuar Tabelës më lart realizimi i fondeve buxhetore për shpenzimet kapitale Janar- Dhjetor 2025 është në masën 56 %.

• “Të ardhurat”

Llogaria	E M E R T I M I	Te ardhurat viti 2025			
		PLAN	FAKTI	Diferenca	%
7110900	Te ardhura nga qerate	16 000	13 227	2 773	82.67%
7113099	Te ardhura nga sherbimet	1 132 500	1 828 380	-695 880	161.45%
7115655	Gjoha per deklarim te vonuar ne RPP	65 000 000	56 047 097	8 792 000	86.47%
7115499	Gjoha (kundravajtje administrative)	60 765 000	64 047 097	-3 282 097	105.40%
7111031	Te Ardhura nga BIFIDEX	0	0	0	0
II	TE ARDHURAT	126 913 500	122 096 704	4 816 796	104%

Për vitin 2025, QKB ka realizuar të ardhurat sipas tabelës së mësipërme dhe janë derdhur 100% në buxhetin e shtetit.

4. Bashkëpunimi ndërinsitucional

Që në fillimet e saj, QKB në kuadër të bashkëpunimit ndërinsitucional, konkretisht me DPT, ka mundësuar aksesin në sistemin tatimor përsa i përket verifikimit të detyrimeve tatimore në kohë reale për subjektet të cilat aplikojnë pranë QKB-së për çregjistrim të biznesit apo për pezullim të aktivitetit. Kjo arritje sjell lehtësi në procesin e këtyre shërbimeve dhe më kryesorja përkthehet në shërbim efikas dhe në kohë reale për qytetaret dhe bizneset.

Bashkëpunon me Autoritetin Kombëtar të Ushqimit, përsa i përket regjistrimit të subjekteve tregtare, duke plotësuar kërkesat e Aktit Normativ nr. 4, datë 16.8.2012, “Për përcaktimin e rregullave për therjen e kafshëve dhe tregtimin e mishit të tyre”.

Për licencat e grupit III, *Sektori i Leje, Licensa dhe Autorizime*, bashkëvepron me institucione të tjera në procesin e licencimit.

- Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, Ministria e Brendshme
- Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, Inspektoriati Zooteknik, Inspektoriati i Mbrojtjes së bimëve, Shërbimi i kontrollit të plehrave kimike, Agjencia Kombëtare e Duhan-Cigare, Drejtoria e Politikave të Peshkimit- Ministria e Bujqesise dhe Zhvillimit Rural
- Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
- Agjencia Kombëtare e Mjedisit, Ministria e Mjedisit
- Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
- Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave
- DPSHTRR
- Autoriteti i Aviacionit Civil Shqipëtar
- Ministria e Arsimit
- Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit

QKB, bashkëvepron nëpërmjet Sistemit të Qarkullimit të Dokumenteve me Nënshkrim Elektronik (SQDNE) me institucione të tjera duke komunikuar dhe shkëmbyer dokumente shoqëruese të kërkuara për vërtetimin e plotësimit të kriterëve të licencimit/lejimit.

Bashkëpunon me çdo institucion tjetër, duke respektuar të drejtën e informimit përsa i përket kërkesave për informacion/dokumentacion.



5 Prioritetet për vitin pasardhës

Bazuar në përvojën dhe rezultatet e vitit 2025, QKB ka përcaktuar objektiva të qarta për vitin 2026, të orientuara drejt rritjes së mëtejshme të cilësisë së shërbimit për publikun dhe subjektet tregtare, standardizimit të proceseve ndërinstitucionale, rritjes së eficiencës në administrimin e të dhënave, përmirësimit të kapaciteteve të brendshme dhe thellimit të digjitalizimit dhe inovacionit në shërbim. Këto objektiva synojnë konsolidimin e rolit të QKB-së në ofrimin e shërbimeve publike moderne, transparente dhe të orientuara drejt qytetarit sim ë poshtë:

➤ Rritja e cilësisë së shërbimit për publikun dhe subjektet tregtare

- Ofrimi i asistencës së standardizuar, të qartë dhe në kohë reale përmes të gjitha kanaleve të komunikimit (linja e gjelbër, email, chat online).
- Ulja e paqartësive dhe gabimeve gjatë aplikimeve online në të tre regjistrat përmes udhëzimit teknik dhe procedural.
- Standartizim të procedurave në të tre regjistrat
- Përmirësim të komunikimit me biznesin
- Përditësim i udhëzimeve informuese
- Rritja e përqindjes së popullimit të regjistrit nëpërmjet nismave ndëgjegjësuese dhe informuese (pop-up, fushata, broshura, njoftime në rrjetet sociale) për të ndihmuar subjektet raportuese lidhur me detyrimet e tyre për të regjistrim fillestar dhe çdo ndryshimi në të dhënat e RPP.

➤ Standardizimi dhe përmirësimi i proceseve ndërinstitucionale

- Përpunimi korrekt, i plotë dhe në kohë i korrespondencës me institucionet partnere (tatime, bashki, ILDKPKI, SPAK, prokurori).

- Ngritja e praktikave të përbashkëta për menaxhimin e njoftimeve zyrtare, dokumentacionit dhe verifikimeve elektronike.
- Automatizimi i proceseve administrative për rritje efieencie dhe reduktim të gabimeve.
- Forcimin e ndërveprimit institucional me DPT dhe regjistrin e OJF-ve, për marrjen në kohë reale të regjistrimit të subjekteve raportuese që kanë detyrimin e pasqyrimit të të dhënave në RPP (nëpërmjet platformës SQDNE ose mënyra të tjera).
- **Rritja e efieenciës në administrimin e të dhënave**
 - Përpunimi i saktë, i strukturuar dhe i sigurt i të gjitha të dhënave të hyrjes (aplikime, njoftime, lista të personave të ndaluar, dokumente zyrtare, aplikime në regjistra).
 - Mirëmbajtja e integritetit të të dhënave të regjistrave, duke siguruar përputhje me kuadrin ligjor për mbrojtjen e të dhënave personale.
- **Përmirësimi i kapaciteteve të brendshme dhe monitorimi i performancës**
 - Përcaktimi i indikatorëve të qartë të performancës
 - Rritja e kapaciteteve profesionale të stafit përmes trajnimeve, udhëzimeve procedurale dhe praktikave të unifikuara pune.
- **Digjitalizimi dhe inovacioni në shërbim**
 - Zgjerimi dhe optimizimi i kanaleve të asistencës online, duke përforcuar platforma të reja si Ticket apo chat online
 - Përmirësimi i vazhdueshëm i shërbimeve online të ofruara nga QKB.
 - Përdorimi efektiv i mjeteve teknologjike për analizimin, kategorizimin dhe procesimin e kërkesave të publikut dhe institucioneve.
 - Zhvillimi shërbimeve të reja të integruara si: Aplikim i njëkohshëm për regjistrimin e ndryshimeve për subjektet të regjistruara në regjistrin tregtar me pronësi “Direkte”.
 - Modernizimi i mëtejshëm i sistemit elektronik të Regjistrit të Pronarëve Përfitues.
- **Sigurimi i një qarkullimi të pandërprerë dhe të kontrolluar të informacionit**
 - Hartimi, kontrolli dhe shpërndarja në mënyrë korrekte e njoftimeve, shkresave, përgjigjeve zyrtare dhe aplikimeve në të tre regjistrat
 - Bashkërendimi i veprimeve ndërmjet sektorëve për të garantuar një fluks të unifikuar dhe të pa ndërprerë të komunikimit.
- **Finalizimi i furnizimit me pajisje teknologjike dhe logjistike për stafin.**
- **Mirëmbajtja e vazhdueshme e sistemit HRMIS.**
- **Forcimi i planifikimit strategjik të burimeve njerëzore.**

5.1 Sfidat e hasura gjatë vitit 2025

Identifikimi i sfidave strukturore dhe rreziqeve që kanë ndikuar në performancë.


- Gjatë analizës së performancës për periudhën raportuese janë identifikuar një sërë sfidash strukturore dhe rreziqesh që kanë ndikuar në nivelin e efieenciës dhe cilësisë së shërbimit të

ofruar nga QKB.

- Ndër sfidat kryesore evidentohet rritja e vazhdueshme e volumit dhe kompleksitetit të kërkesave për asistencë. Struktura fillestare e orientuar drejt një modeli reagues, mungesa e indikatorëve të qartë të performancës dhe standardizimi jo i plotë i proceseve kanë ndikuar në nevojën për riorganizim të brendshëm dhe konsolidim të praktikave të punës.
- Një sfidë tjetër strukturore ka qenë varësia e lartë nga funksionimi i sistemeve digjitale dhe infrastruktura teknologjike, ku çdo ndërprerje apo problem teknik ka potencialin të ndikojë drejtpërdrejt në vazhdimësinë e ofrimit të asistencës në kohë reale.
- Intensifikimi i ndërveprimit ndërinstitutional dhe trajtimi i kërkesave me natyrë sensitive kanë rritur nivelin e përgjegjësisë ligjore dhe kërkesën për saktësi të lartë në përpunimin e të dhënave, duke shtuar nevojën për kontrole të brendshme më të forta dhe përditësim të vazhdueshëm të njohurive procedurale.
- Në planin organizativ, ngarkesa e lartë operative dhe dinamika e komunikimit shumëkanalësh (telefon, email, chat, ticket, aplikime) kanë paraqitur rrezik për mbingarkesë të stafit, me ndikim të mundshëm në kohën e përgjigjes dhe në saktësinë e trajtimit të kërkesave.
- Nevoja për koordinim të vazhdueshëm ndërsektorial dhe harmonizim të komunikimit institucional dhe ndërinstitutional ka paraqitur sfida në ruajtjen e një qasjeje të unifikuar dhe të standardizuar ndaj publikut.
- Në kuadër të kalimit të të gjithave shërbimeve online nëpërmjet portalit qeveritar e- Albania, identifikohet shtimi i nevojës për orinetim/sqarime, duke qenë se jo të gjithë qytetarët/subjektet kanë njohuritë e duhura për të plotësuar saktë të dhënat në aplikim apo të ngarkojnë gjithë dokumentacionin e nevojshëm shoqërues, çka sjell pezullimin e aplikimeve.
- Pamundësia për të gjeneruar të dhëna nga sistemet e të tre regjistraave nga nëpunësit e Drejtorisë së Regjistrave dhe Analizës
- Në tërësi, këto sfida dhe rreziqe kanë ndikuar në performancë kryesisht në aspektin e menaxhimit të fluksit, standardizimit të proceseve dhe optimizimit të burimeve, duke nxitur ndërmarrjen e masave konsoliduese për forcimin e strukturës organizative, përmirësimin e mekanizmave të kontrollit të brendshëm dhe rritjen e kapaciteteve profesionale të stafit, me qëllim garantimin e një shërbimi të qëndrueshëm, cilësor dhe në përputhje me standardet institucionale.


6 Aneks

- Më poshtë po japim të dhëna statistikore mbi regjistrat dhe regjistrimet e kryera gjatë vitit 2025 krahasuar me vitet paraardhëse




Nga krahasimi i bërë për periudhën 2020 – 2025, numri i regjistrimeve ka qenë më i lartë gjatë vitit 2025 me 20 765 regjistrime, ndërsa numri më i ulët i regjistrimeve ka qenë në vitin 2020. Nga viti 2020 deri në vitin 2025 kemi një rritje prej 32.7% në numrin e regjistrimeve të bizneseve të reja.

- Subjekte aktive me të paktën një ortak me pronësi të huaj deri në fund të vitit 2025




- Biznese me të paktën një ortak me pronësi të huaj nga vendet kufitare me Shqipërinë deri në fund të vitit 2025



Deri në vitin 2025, numrin më të lartë të biznesve aktive me të paktën një ortak të huaj e ka Italia me 6358 subjekte, ndjekur nga Kosova me 1609 subjekte, Greqia me 786 subjekte, Maqedonia e Veriut me 492 subjekte dhe Mali i Zi me 75 subjekte.

➤ Numri i çështjeve të shqyrtuara në Qendrën Kombëtare të Biznesit



Ky raport bazohet në punën e kryer nga regjistruesit e të tre regjistrave, duke përfshirë edhe shqyrtimin e çështjeve më shumë se një herë, në rastet kur ato marrin statusin “E paplotë”. Gjatë vitit 2025, numrin më të lartë të aplikimeve në Qendrën Kombëtare të Biznesit e mban Regjistri Tregtar me 89.2% të totalit të aplikimeve ndjekur nga Regjistri i Pronarëve Përfitues me 8% dhe nga Regjistri i Leje/Licencave dhe Autorizimeve me 2.8%.

Subjektet e çregjistruara nga viti 2020-2025 janë si më poshtë:



Nga krahasimi i subjekteve të çregjistruara shikohet një ulje e bizneseve të çregjistruara.

Dokumentacioni shoqërues i këtij raporti vjetor paraqet bazën teknike dhe analitike mbi të cilën mbështetet vlerësimi i performancës institucionale për periudhën raportuese. Ai përfshin dokumente mbështetëse, tabelë statistikore dhe grafike, të cilat sigurojnë transparencë, saktësi dhe gjurmueshmëri të plotë të të dhënave të paraqitura. Përmes këtij dokumentacioni mundësohet verifikimi i treguesve sasiorë, interpretimi i tyre në kontekstin operacional si dhe kuptimi i metodologjisë së ndjekur për përpunimin dhe analizën e informacionit. Në këtë mënyrë, raporti mbështetet në evidenca të strukturuar dhe të standardizuara, duke garantuar koherencë me kërkesat e kontrollit të brendshëm dhe standardet e raportimit institucional.